



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 99, datë 29.07.2020

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË RREGULLORES NR. 89, DATË 27.06.2016 “PËR
KRITERET DHE KËRKESAT PËR MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE TË
SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE
KOLEKTIVE DHE SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË PENSIONIT
VULLNETAR”**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, pikës 5 të nenit 195 dhe nenit 35 të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe nenit 33 të Ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e ndryshimeve të Rregullores nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, e ndryshuar, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR
Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**

Ndryshimet e Rregullores nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, e ndryshuar, bëhen sipas tekstit më poshtë:

Neni 2, rishikohet baza ligjore, si në vijim:

“Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 33, pika 5, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” dhe nenit 35, pikës 5 të nenit 195 , të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive.”

Në nenin 3, pika 1, ndryshon referenca ligjore ku togfjalëshi “në Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i ndryshuar, zëvendësohet me togfjalëshin “Ligjin 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Në nenin 3, mbas pikës 1/b, shtohen geramat b/1 dhe b/2 si në vijim:

“b/1 Shoqëria e auditimit duhet të ketë si pjesë të brendshme të strukturës së shoqërisë, burimet njerëzore me kompetencat e duhura profesionale për të kryer auditimin ligjor, ku në ekipin e auditimit të ketë minimumi 2 anëtare (pa përfshirë ortakun e angazhimit) të cilët të jenë me eksperiencë në mbikqyrjen dhe/ose kryerjen e angazhimeve të auditimeve ligjore në institucione financiare.

b/2 I njëjti ekip auditimi, të mos jetë i angazhuar në më shumë se dy auditime të shoqërive administruese.”

Në pikën 1/c të nenit 3, shtohet togfjalëshi, si në vijim:

“...sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 35 të Ligjit 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.”

Pika 1/d e nenit 3, riformulohet, si në vijim:

“d. Të mos jetë subjekt i masave disiplinore nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, për aq kohë sa kjo masë është në fuqi.”

Pika 1/b e nenit 4, ndryshon si në vijim:

“b. Metodologjia e auditimit e propozuar duke përfshirë theksin në fushat kryesore dhe qasja përkatëse e auditimit. Programin e auditimit të shoqërisë dhe ekspertët e jashtëm të angazhuar nga shoqëria e auditimit.”

Pika 1/c e nenit 4, shtohet, si në vijim:

“...Letra e angazhimit të shoqërisë audituese duhet të parashikojë edhe:

a) komunikimin e shoqërisë së auditimit me strukturën përgjegjëse për auditimin e brendshëm të

shoqërisë administruese,
b) letrën e drejtimit dhe
c) letrën e përfaqësimit.”

Në pikën 1/e të nenit 4, mbas fjalës “Vërtetim” shtohet togfjalëshi “nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike”.

Neni 6, riformulohet si në vijim:

“Autoriteti mund të refuzojë shoqërinë audituese të propozuar nga shoqëria administruese, nëse:

- i. Nuk përmbushen kriteret dhe kërkesat e parashikuara në Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, Ligjin nr. 56/2020 “Për SIK” dhe të kësaj rregullore;
- ii. Shoqëria audituese në rastet kur është kryer një kontroll i cilësisë së punës, është vlerësuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, nën notën C.”